



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.556/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit B. Sh sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.603/16 të dt.22.6.2016, për shkak të veprës penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit B. Sh dhe të prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi me dt17.7.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. Sh i lindur me dt.17.2.1985 në Pejë , me vendbanim në fsh. T. Komuna e Pejës , i biri i H dhe nënës F e gjinisë Gj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , më parë i pa dënuar, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 02.3.2016, rreth orës 10:50 , në kryqëzim të rrugës “Lekë Dukagjini” dhe rrugës “Nëna Terezë” Komuna e Pejës , nga pakujdesia ka shkelur ligjin për sigurinë e komunikacionit rrugor nga neni 42 pika 1 , në atë mënyrë që i pandehuri duke drejtuar automjetin e llojit “Opel” T98 , me ngjyrë të bardhë dhe me targa ----- , me të arritur në vendin e lartcekur , i njëjti nuk rreshtohet në formë n e duhur për kthim në të majtë dhe fillon të kyçet në rrugën Lekë Dukagjini , në të majtë në drejtim të qendrës , dhe i njëjti pa u siguruar se nuk e pengon lëvizjen e automjeteve , ku me këtë veprim ia ndërprente rrugën automjetit të llojit “VW Golf” me targa ----- , të cilën ishte duke e drejtuar i dëmtuari A. N , i cili ishte duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi ku si pasojë e këtij veprimi , ky i fundit me vonesë e vëren të pandehurin se është duke ia ndërprerë rrugën , pasi që nga ana e djathtë nga e cila është kyçur i pandehuri ka qenë e pamundshëm dhe për këtë shkak të afërsisë që kishte të reagoj në frenim dhe me pjesën e parë ballore të anës së majtë e godet automjetin e të pandehurit në pjesën anësore të pasme të anës së majtë , ku si pasojë e këtij aksidenti përveç dëmeve materiale , lëndime të lehta trupore ka pësuar i dëmtuari A. N .

-me çka ka kryer veprë penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 378 par 6 e lidhur par 1 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësorë dhe shpenzimeve të procedurës penale ..

I dëmtuari për realizimin eventual e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.22.6.2016 kundër të pandehurit B. Sh , ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.527/16, për vepre penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së ,duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , gjendjen e varfër ekonomike, faktin se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i vetëm i familjes prej 6 anëtarësh , dhe kësisoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 17.7.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .